SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE OSE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

PROCEDURA

Pranim në kategorinë e nëpunësve civil të nivelit ekzekutiv.

KATEGORIA

Kategoria e Ekzekutive

POZICIONI

- ***Dy specialistë, Sektori i Projektimit Inxhinierik dhe Arkitektonik, në Drejtorinë Projektimit Urban- Klasa IV-2***

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, Bashkia Elbasan shpall proçedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive për pozicionin:

- ***Specialist, Sektori i Projektimit Inxhinierik dhe Arkitektonik, në Drejtorinë Projektimit Urban- Klasa e Pages IV-2***

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për të gjitha procedurat (*lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil*) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve: 19.10.2026 **LËVIZJE PARALELE**
Afati për dorëzimin e dokumenteve: 24.10.2026 **PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

I. Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Harton projekte zbatimi + preventiva dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm të parashikuar në V.K.M nr.**68** ,datë 15.02.2001 *"Për miratimin e standarteve dhe kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit" dhe* në V.K.M Nr.**629** , datë 15.07.2015 *"Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre"*, për çdo projekt publik (rrugë,lulishte,parqe,kopshte, shkolla,objekte publike ,banesa kolektive,kënde sportive,etj.) që financohet nga buxheti i Bashkisë ,grantet e qeverisjes vendore apo donatore në perputhje me punimet që i njihen në liçensen profesionale.
Harton çdo projekt tjetër për interes të Bashkisë me urdhër të veçante të Drejtorit të drejtorisë dhe titullareve të Bashkisë.
Kryen evindentimin e të gjithë objekteve apo pronave që preken nga projektet e zbatimit apo project-propozimet dhe pergatit relacionin për marrjen e vendimeve të shpronesimit apo për prishje bazuar në informacionin e sjellë nga I.M.T.
Është i detyruar për çdo projekt ku është autor apo bashkëautor të mbajë kontakte me firmën zbatuese dhe të japë zgjidhje tekniko-ekonomike për çdo problem apo mospërputhje ndërmjet projektit dhe zbatimit në terren.
Raporton për çdo problem teknik që kerkon zgjidhje të specializuar tek eprori.
Çdo specialist mban përgjegjësi vetjake për projektet dhe preventivat ku eshte autor në perputhje me zërat e punimeve për të cilat është i liçensuar.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

1. Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
2. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
3. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë";

Të plotësojnë kushtet dhe kerkesat e posaçme, si vijon:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit Bachelor/ Master Profesional/ Master Shkencor në Shkencat Inxhinierike, diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
2. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
3. Të ketë përvojë pune në hartimin e projekteve inxhinierike

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard
b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
h- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë displinore në fuqi.
i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Elbasan, brenda datës 19.10.2026

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **21.10.2026** Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Bashkisë Elbasan, do të shpallë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (portali "Shërbimi Kombëtar i Punësimit"), faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nëpërmjet adresës së tyre të e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

a) Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* i ndryshuar;
b) Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*";
c) Ligjin nr.90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*";
d) Ligjin nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
e) Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*;
f) Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të intereresave"*;
g) Ligjin nr. 119/2014, *"Për të drejtën e informimit"*;
h) Ligjin nr. 8517, datë 22.07.1999 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar;
i) Ligjin nr.107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*"
j) V.K.M Nr**.629** , datë 15.07.2015 *"Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre"*

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individale në punë në rastet kur proçesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë.**

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "*Për proçesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*", të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al. http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Elbasan do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (portali "Shërbimi Kombëtar i Punësimit"), faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail-it) për datën e saktë të shpalljes së fituesit dhe rezultatet.

2 PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, nuk plotësohet në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës për pranim në shërbimin civil

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët në procedurën e pranimit në shërbimin civil:

a) Të jetë shtetas shqiptar;
b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.

Të plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si vijon:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit Bachelor/ Master Profesional/ Master Shkencor në Shkencat Inxhinierike, diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

2.Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;

3. Përvoja e punës në hartimin e projekteve inxhinierike përbën përparësi;

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

j- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard
k- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
l- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
m- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
n- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
o- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
p- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
q- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë displinore në fuqi.
r- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti me zarf të mbyllur pranë Bashkisë Elbasan, brenda datës 24.10.2026

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **03.11.2026,** Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Bashkise Elbasan, do të shpallë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (portali "Shërbimi Kombëtar i Punësimit"), faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nëpërmjet adresës së tyre të e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

a) Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* i ndryshuar;
b) Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*";
c) Ligjin nr.90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*";
d) Ligjin nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
e) Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*;
f) Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të intereresave"*;
g) Ligjin nr. 119/2014, *"Për të drejtën e informimit"*;

h) Ligjin nr. 8517, datë 22.07.1999 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar;
i) Ligjin nr.107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*"
j) V.K.M Nr**.629** , datë 15.07.2015 *"Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre"*

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a- Vlerësimin me shkrim, deri në **60 pikë**;
b- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **25 pikë;**
c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **15 pikë;**

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "*Për proçesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*", të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al. http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore- Bashkia Elbasan, do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të "Agjencisë Kombëtare të Punësimit" (portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit), faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email-it).

BASHKIA ELBASAN

Drejtoria e Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Informacionit